



VENDIM
Nr.83 Datë 15.11.2010

PËR
MIRATIMIN E APLIKIMIT TË KESH SH.A PËR MIRATIMIN E
PLANT TË INVESTIMEVE TË VITIT 2011

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 8 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga te Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

Aplikimi i KESH sh.a për planin e investimeve për vitin 2011 përmbush përgjithësisht detyrimin e paraqitjes së aplikimit në zbatim të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga te Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi :

1. Të miratojë aplikimin e KESH sh.a për miratimin e plant të investimeve të vitit 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA